



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit _ dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenit 36 paragrafi 1, nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtues i njohur, në seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021, KSHPK morri

VENDIM

Procedura e ngritur pas denoncimit për korrupsion nr.12-1757/1 me datë 22.03.2019 dorëzuar nga parashtues i njohur – person fizik – Nesho Petkoviq, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-1757 nga viti 2019 formuar në bazë të denoncimit nr.12-1757/1 me datë 22.03.2019

Lënda me numër 12-1757 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Një kopje nga vendimi të dorëzohet deri tek parashtuesi i denoncimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-1757 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-1757/1 me datë 22.03.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror nëpërmjet postët elektronike, nga parashtues i njohur, person fizik, Nesho Petkoviq, me postë elektroike të njohur.

Me akuzat në denoncim dhe shtojcë të dorëzuara tregon për dyshime për veprim kundërligjor dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare nga ana e personit Anita Stoshiq – pronar i subjektit juridik SHPTSHIP Mak Benz Transport SHPKNJP Import-eksport Kumanovë.

Nga akuzat e përmbajtura në denoncimin e lëndës, gjithashtu, Komisioni shtetëror erdhi në njohuri se personi i përmendur, në bazë të punësimit fiktiv në subjektin juridik në pronësi personale, ka bërë transaksione bankare për pagesë të rrogës të personit të punësuar fiktiv – Dragan Dimitrievski nga Kumanova, në periudhën prej vitit 2016 deri 1018, në të cilën periudhë D. Dimitrievski nuk ka qëndruar në Republikën e Maqedonisë, gjegjësisht ka qëndruar dhe ka qenë i punësuar në Republikën e Bullgarisë.

Gjatë veprimit për denoncimin e lëndës, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke u nisur nga akuzat e parashtuesit, me qëllim të caktimit të gjendjes faktike bëri edhe kontrollime administrative adekuate në lidhje me besueshmërinë dhe mbështetjen në mënyrë që të ndërmerre procese vepruese – dorëzoi kërkesë dhe urgjencë – pas kërkesës së të dhënave dhe informacioneve – me shtojcë dokumentacion nga Ministria për punë të brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Rrjedhimisht, përshkak të dorëzimit të kërkesës, deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit është dërguar përgjigje me shkrim nga e cila buron se nga ana e

Ministrisë për punë të brendshme kërkesa e lëndës, gjegjësisht urgjenca është dorëzuar deri tek Prokuroria themelore publike në Kumanovë.

Me përgjigjen e dorëzuar, gjithashtu është informuar Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit se nga ana e prokurorisë adekuate me datë 30.09.2020 është dhënë Urdhëresë RO nr.343/20 në bazë të së cilës vepron Ministria për punë të brendshme në mënyrë që ka filluar të bënë kontrollime nëpërmjet kërkesës për informimet e nevojshme deri tek institucionet adekuate, gjegjësisht se procedura për këtë lëndë është në vazhdim.

Në përputhje me të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, konstaton se për akuzat e lëndës kanë vepruar dhe veprojnë organe tjera kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për këtë, në bazë të të gjitha rrethanave të rastit të lëndës së denoncuar Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka bazë për veprim të mëtutjeshëm në përputhje me kompetencat e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit të caktuara me nenin 17 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar, dhe kundër këtij nuk është e lejuar ankesa.

Është vendosur me datë 12 shkurt të viti 2021 me numër 12-152/216-02-2021

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: H. M., këshilltarë

Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

Dorëzuar deri tek:

- Arkiva
- Parashtruesi

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ KОРРУПСИОНИТ**
Kryetarë: Biljana Ivanovska